



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA IV**

**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 63

Prishtinë, më 04.12.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE  
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ahmet Isufi, Rexhep Selmi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Danush Ademi

**Përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme:** Bajram Rexhepi, Ministër dhe Shpend Maxhuni, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës

**Nga Stafi Mbështetës i Komisionit:** Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

**Mbledhjen e kryesoi:** Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 19.10.2012 dhe 06.11.2012;
3. Raportimi i Ministrit të Punëve të Brendshme për situatën e sigurisë në Republikën e Kosovës;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013;
5. Të ndryshme

*Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.*

### **1. Miratimi i Rendit të ditës.**

**Kryetari i Komisionit-** Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

### **2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 19.10.2012 dhe 06.11.2012;**

**Kryetari i Komisionit-** Konstatoi miratimin e Procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtur më 19.10.2012 dhe 06.11.2012 të cilët u miratuan pa vërejtje.

### **3. Raportimi i Ministrit të Punëve të Brendshme për situatën e sigurisë në Republikën e Kosovës.**

**Kryetari i Komisionit-** Në këtë pikë të rendit të ditës hapi takimin me Ministrin e Punëve të Brendshme, z. Bajram Rexhepi. Për raportet e bashkëpunimit institucional mes Ministrisë e falënderoi Ministrin dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, duke shtuar se këto raporte varen nga zhvillimet në vend, për të cilat institucione Komisioni ka kompetencë t'i mbikëqyr, dhe fjalën ia kaloi Ministrit, z. Bajram Rexhepi për të njoftuar për situatën në veri të vendit dhe situatën e përgjithshme në Kosovë.

**Ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi-** Tha se kërkesave të Komisionit për raporte dhe takimeve të drejtpërdrejta, Ministria i është përgjigjur, i cili është një obligim ligjor dhe se bashkëpunimi është në interes të vendit.

Tutje shtoi se muajve të fundit situata e sigurisë është e qetë dhe nën kontroll, ku përveç në pjesën veriore ku ka incidente të kohëpaskohshme të cilat nuk kanë reflektuar në destabilizimin e situatës së sigurisë. Incidente të tilla kanë qenë të pa paralajmëruara ose të lajmëruara, të cilat kanë qenë të koncentruar në disa drejtime, siç ishte shprehja e pakënaqësisë me arritjen e marrëveshjes për menaxhimin e integruar të kufijve, për të cilën gjë njerëzit e përfshirë në krim të organizuar nuk duan të paguajnë taksat, gjithashtu kanë paralajmëruar veprime të dhunshme për të penguar zbatimin e marrëveshjes.

Gjithashtu tha se, me 4 dhjetor, 2012 në pikën kufitare në Jarinje, janë mbledhur të ashtuquajturit kryetar të komunave dhe grupe të caktuara, të cilët kanë bërë dëmtime duke e penguar punën, për të cilën gjë janë informuar zyrtarët vendor në Bruksel për ndërmarrjen e masave, në mënyrë që marrëveshja të realizohet dhe se zbatimi i marrëveshjes për menaxhimin e integruar të kufijve pritet të filloj nga 10 dhjetori 2012, dhe se nga ana e institucioneve vendore janë duke u bërë përgatitjet, gjithashtu në këtë proces duhet të kenë rol EULEX-i dhe KFOR-i, të cilët duhet të garantojnë sigurinë për punëtorët dhe pajisjet dhe kjo marrëveshje të realizohet.

Ndërsa në pjesën “*Kroi i Vitakut*”, vazhdon ri ndërtimi i shtëpive dhe se në këtë pjesë, kohë pas kohe ka incidente nga ana e grupeve të caktuara, të cilat kanë qëllim të pengojnë kthimin e qytetarëve në shtëpitë e tyre. Ky proces vazhdon të përkrahet me fondet e qeverisë komunale dhe qendrore, proces i cili ka vështirësi në disa zona të thella pranë Kodrës së Minatorëve, por është këmbëngulësi e institucioneve vendore që ky proces të vazhdoj, në kthimin e qytetarëve në shtëpitë e tyre, gjë e cila është theksuar edhe nga z. Smuel Zhbogar dhe Xavier de Marhac.

Gjithashtu theksoi se të ashtuquajturit inspektor të UNMIK-ut, që kanë dashur të pengojnë këtë proces, kanë qenë të pa autorizuar dhe se kjo informatë është dhënë nga përgjegjësi i UNMIK-ut, se nuk është iniciativë e tyre, por e Departamentit të Urbanizmit i cili gjithmonë ka mbështetur strukturat paralele.

Në pjesën veriore mbesin akoma barrikadat e përhershme, në “*Urën e Ibrit*” dhe në rrugën “*Knjaz Milosh*” dhe të tjera që kohë pas kohe bëhen. Në shenjë të pakënaqësisë të disa grupeve të interesit, të cilët nuk pajtohen me vendimet e shtetit serb për vendimet e normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën dhe plotësimin e standardeve evropiane.

Në këtë kohë ka ndodhur edhe disa ngjarje të cilat kanë mundur ta tensionojnë situatën, siç është kthimi në ri gjykim i rastit “*Kleçka*”, protestat me rastin e inaugurimit të “*Rrugës së Kombit*”, manifestimet me rastin e njëqind vjetorit të pavarësisë, ngjarje e cila ka kaluar pa incidente, si dhe një moment i rëndësishëm ishte edhe shpallja e pafajësisë nga Tribunali i Hagës për z. Ramush Haradinaj.

Çështje tjetër është rasti i përgjimeve telefonike të cilat duhet të rregullohen me ligj, dhe në këtë rast janë ndërmarrë veprimet që të bëhen hetimet. Për këtë arsye, me datë 3 dhjetor 2012 është bërë procedimi i ligjit për përgjimin e telekomunikimeve, i cili përcakton rastet se kur mund të përgjohet dhe se për këtë ligj ka pasur pengesa nga ana e EULEX-it, por është parë e nevojshme përcaktimi i kësaj çështje. Gjithashtu përmendi se edhe në veprimet e 25 korrikut, të vitit 2011 struktura të caktuara kanë bërë përgjime. Ministria e Punëve të Brendshme, ka bërë hetimin dhe se këto përgjime nuk janë bërë nga ana e Policisë së Kosovës.

Kufijtë e Republikës së Kosovës janë të sigurt, por asnjë kufi nuk është hermetik dhe kjo është e dukshme në pjesën veriore të vendit, ndërsa “*vija e gjelbër*” e cila është kompetencë e KFOR-it, nuk është kontrolli i plotë dhe ka kalime ilegale dhe kontrabandime, dhe se kjo çështje do të rregullohet me kalimin e kompetencave tek vendorët.

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Shpend Maxhuni-** Policia e Kosovës vazhdon me përmbytjen e detyrave të cilat janë përcaktuar në kuadër të objektivave strategjike, dhe se fokusi kryesor ka qenë parandalimi i të gjitha aktiviteteve kriminale. Duke iu falënderuar angazhimit të policisë, janë realizuar një sërë operacione policore të cilat kanë rezultuar me sukses dhe se prioritet ka qenë luftimi i narkotikëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore, gjithashtu në fokus ka qenë sekuestrimi i armëve pa leje të cilat kanë qenë në pronësi të qytetarëve dhe se ky aktivitet ka përafruar bashkëpunimin e Policisë së Kosovës me shtetet fqinjë dhe agjencionet homologe në rajon.

Gjatë vitit 2012 Policia e Kosovës ka qenë aktive në terren në luftimin e krimit të organizuar në nivel ndërkombëtar, ku në bashkëpunim me policitë tjera në shkëmbimin e informacioneve ka arritur rezultate konkrete. Synimi është që Policia e Kosovës të

anëtarësohet në mekanizmat ndërkombëtar të sigurisë, Interpol dhe Europol, dhe kjo është në kuadër të planifikimit strategjik që mbulon periudhën afatmesme 2011-2015.

Në sferën e sigurisë publike më shqetësuese është gjendja e sigurisë në veri të vendit dhe se në këtë pjesë ekziston një brishtësi e situatës e cila vazhdon të menaxhohet nga KFOR-i, EULEX-i dhe Policia e Kosovës dhe nga kontaktet e vazhdueshme kërkojmë një qasje bashkëpunuese me situatën e sigurisë në veri të vendit. Ndërsa pjesa “*Kroi i Vitakut*” është nën përgjegjësinë e stacionit policor në veri të Mitrovicës, gjithashtu ekziston gatishmëri nga ana e zyrtarëve policor të komunitetit serb për ballafaqimin me rrethanat e mundshme në terren.

Nga informacionet që ka Policia e Kosovës, vazhdon të ketë aktivitetet ilegale në brezin kufitar, “vija e gjelbër” dhe se kërkesat nga ana e policisë janë të vazhdueshme ndaj mekanizmave ndërkombëtar. Gjithashtu njoftoi se me datë 04.12.2012, në pikën kufitare në Jarinje, një grup i organizuar nga Serbia dhe grupi tjetër i organizuar në veri të Kosovës janë drejtuar në pikën kufitare në Jarinje, duke dëmtuar rrethojat në këtë pikë, ndërsa KFOR-i dhe EULEX-i, janë dislokuar në aspektin operacional.

Policia e Kosovës do të vazhdon në përmbushjen e obligimeve, pas fillimit të zbatimit të marrëveshjes për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, por pika kufitare në Jarinje konsiderohet një nga vështirësitë, kjo për shkak të tendencave dhe qasjes destruktive nga elementet kriminal dhe politika ditore në pjesën veriore

**Kryetari i Komisionit-** Konsideroi se është angazhim i Policisë së Kosovës për kryerjen e obligimeve në gjithë territorin e Kosovës dhe kjo në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ligjeve në fuqi, në mënyrë që mos ti referohemi situatës si e brishtë ose stabile, pasi ka probleme në funksionimin në veri të Kosovës.

Tutje bëri pyetjen për Ministrin, Rexhepi, si në vijim

Pse veprohet në mënyrë selektive nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, pasi në disa situata tregohet përgatitja e njësive speciale, por në disa raste kur bëhen veprime kundër ligjore, siç është rasti në veri të vendit dhe nuk ndërmerren veprime dhe se kjo len të kuptohet se veprimet merren mbi baza politike?

**Fatmir Xhelili-** Tha se kufijtë e shtetit të Kosovës nuk kontestohen nga shtetet e mëdha dhe ato të Bashkimit Evropian, ndërsa në veri të vendit kemi ushtrimin e dhunës nga disa grupe të caktuara.

Në lidhje me këtë situatë, bëri pyetjet si në vijim, drejtuar Ministrit, z. Bajram Rexhepi.

Ku është vendimmarrja e grupeve të caktuara, të cilët organizohen për të ushtruar dhunë, është tek faktori politik jo ligjor në Kosovë, tek grupet e organizuara kriminale apo nga instrumentet e shtetit serb? A është analizuar kjo situatë dhe a ka të dhëna inteligjente? A është planifikuar ndonjë veprim në drejtim të grupeve që ushtrojnë dhunë duke identifikuar edhe vendimmarrësit?

Duke ditur që në pjesën veriore, për sigurinë publike përgjegjëse është EULEX-i, a është ofruar nga ana e Policisë së Kosovës ndonjë plan konkret për bashkëveprim në ndjekjen dhe shkatërrimin e grupeve kriminale?

**Bajram Rexhepi-** Referuar pyetjes së Kryetarit të Komisionit, tha se veprimet nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme mund të duken selektive, dhe se asnjëherë nuk është thënë që janë kapacitetet e plota për pjesën veriore, pasi situata atje është më komplekse e

cila përfshinë çështje politike, ekonomike dhe të sigurisë. Të gjitha veprimet në pjesën veriore bëhen në bashkëveprim me faktorin ndërkombëtar, vetëm në rastet kur rrezikohet jeta e qytetarëve reagon Njësia Speciale.

Në pjesën “*Kroi i Vitakut*” janë dislokuar njësit speciale operative në gatishmëri, të cilat nuk kanë vepruar. Ministria e Punëve të Brendshme është e përkushtuar të veprojë në mënyrë të njëjtë dhe jo selektive, por rrethanat në veri janë më specifike dhe ajo çfarë kërkohet të ndërmerret është e pa realizueshme, pasi duhet forcimi i kapaciteteve operacionale, reformimi i Policisë së Kosovës që vepron në veri, pasi ka zyrtar policor që marrin paga të dyfishta dhe kjo bën që të kenë lojalitet ndaj institucioneve të Serbisë.

Strukturat që veprojnë në veri, janë struktura legale të Serbisë, por në strukturat e sigurisë të një shteti nuk mund të ketë struktura të një shteti tjetër, por realiteti në veri është ai që është dhe për këtë ekziston bashkëpunimi me ndërkombëtarët dhe gjatë procesit të normalizimit është obligim i Serbisë tërheqja e strukturave, duke u lënë hapësirë institucioneve kompetente, KFOR-it, EULEX-it dhe Policisë së Kosovës.

Ndërsa në përgjigjeje të pyetjeve të z. Fatmir Xhelili, tha se çështja e vendimmarrjes në veri është komplekse, pasi të gjitha strukturat kriminale në veri janë bërë me miratimin e institucioneve të Serbisë, të cilat kanë dashur të kenë kontroll, nëpërmjet strukturave kriminale dhe të pa ligjshme, pasi Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë dhe Agjencia e Shërbimeve të Sigurisë e Serbisë, janë mbështetës të këtyre strukturave që merren me krim të organizuar.

Gjithashtu edhe të ashtuquajturit kryetar të komunave janë të përfshira në administrimin e komunave, në biznes dhe krim. Për pjesën veriore nga ana e Serbisë është tentuar mbajtja e një *status-quo*, në pamundësi të ndarjes të kësaj pjese, por zgjidhja e kësaj çështje kërkon veprime të koordinuara me ndërkombëtarët edhe pse ka raste kur kërkesave të institucioneve vendore për zgjidhjen e kësaj çështje nuk i përgjigjen në mënyrë pozitive.

**Kryetari i Komisionit-** Për vlerësimin e veprimeve nga ana e policisë, bazohemi në veprimet konkrete, të cilat ndryshe kanë qenë në veri të Kosovës, ndryshe në rastin e protestave në promovimin e autostradës “Ruga e Kombit” dhe ndryshe keni vepruar me rastin e protestave të Lëvizjes Vetëvendosje. Kjo mënyrë selektive e veprimit tregon që nuk jeni neutral në ushtrimin e funksionit si Ministër.

**Bajram Rexhepi-** Duhet të pranuar fakti se komponenti i Policisë së Kosovës në veri të vendit është e dobët dhe se me këtë kapacitet nuk mund të veprohet ashtu siç duhet, ndërsa për protestën e cila ka penguar ceremoninë e promovimit të autostradës, tha se nuk është vepruar pasi është bërë vlerësimi i situatës dhe është vepruar në atë mënyrë, ndërsa në rastin e protestës së Lëvizjes Vetëvendosje, kemi vlerësuar se këto janë çështje operative të cilat bëhen sipas situatës dhe janë të natyrave të ndryshme.

**Rexhep Selimi-** Pyeti Ministrin, z. Bajram Rexhepi nëse është i gatshëm që tu përgjigjet të gjitha pyetjeve të tij?

**Bajram Rexhepi-** Tha se do të jetë i gatshëm që tu përgjigjet të gjitha pyetjeve, për aq sa ka informacione dhe mundësi.

**Rexhep Selimi-** Në bazë të funksioneve mbikëqyrëse që ka Komisioni, ju si Ministër jeni ftuar për dëgjim publik dhe për raportim për situatën e sigurisë, me rastin e protestave të 17-18 nëntorit dhe për gjendjen e sigurisë në përgjithësi. Tutje parashtroi pyetjen si në vijim.

Ju keni pranuar se keni dhënë një urdhër operativ për ndërhyrje me datën 17 nëntor 2012, ndaj disa deputetëve në ambientet e Qeverisë së Kosovës.

A mund ta konfirmoni edhe një herë nëse keni dhënë urdhër për ndërhyrjen ndaj deputetëve apo jo, dhe nëse ky urdhër është në përputhje me kompetencat e Ministrit?

**Bajram Rexhepi-** Tha se nuk i mohan ato çfarë ka thënë dhe se urdhrin operativ nuk e ka dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë, por në momentin kur është zhvilluar protesta ka kërkuar që të lirohet lëvizja e zyrtarëve dhe mos të pengohet puna e institucioneve dhe se gjatë gjithë kohës ka qenë në kontakt me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, ndërsa ka kërkuar në mënyrë të përgjithësuar që të lirohet lëvizja.

Ndërsa në mënyrë specifike, njësitë speciale për veprimi kanë marrë urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm dhe se në një situatë të ngjashme njëjtë do të veproja, pasi askush nuk ka të drejtë të pengoj funksionimin e institucioneve, përfshirë edhe deputetët.

**Rexhep Selimi-** Duke iu referuar fjalisë së Ministrit se “askush nuk ka të drejtë të pengoj funksionimin e institucioneve”, tha se deputet të Kuvendit të Kosovës, kanë të drejtë të qëndrojnë në hapësirat e ndërtesës së Qeverisë dhe të Kuvendit dhe bëri pyetjen si në vijim.

A vlerësoni që dhuna e ushtruar ndaj deputetëve ka qenë në përputhje me nevojat apo ka qenë e tepruar?

**Bajram Rexhepi-** Vlerësimet për situatat i bëjmë në bazë të informatave të inteligjencës, pasi nga ana e Lëvizjes Vetëvendosje është deklaruar në media se do të pengojnë procesin e privatizimit në çdo formë. Informacionet që ka poseduar policia që, të gjithë ata që do ta pengojnë këtë proces, në momentin e nënshkrimit të marrëveshjeve të rëndësishme për shtetin, do tu ndalohet qasja, ndërsa lëvizjen normale ua siguron deputetëve imuniteti i tyre, por jo pengimi i funksionimit të institucioneve.

**Rexhep Selimi-** Duke iu referuar fjalisë së Ministrit, Rexhepi, se nga ana e tyre janë poseduar informata inteligjente dhe për këtë bëri pyetjen si në vijim.

A mund të konfirmoni se nga ana e juaj është bërë përgjim?

**Bajram Rexhepi-** Në përgjigjeje të kësaj pyetje tha se, ky konstatim mund të jetë nxjerr nga kontesti dhe nga imagjinata, ndërsa është e qartë se përgjimi bëhet me kërkesë të Prokurorit.

**Rexhep Selimi-** Pas protestave të 17 tetorit 2012, të nesërmen është zhvilluar një protestë në sheshin “Nënë Tereza” ku ka pasur dhunë, ndaj qytetarëve, protestuesve. Gjithashtu në raportet e policisë, është thënë që ka pasur të lënduar edhe zyrtar policor, ndërsa nuk është parë ndonjë zyrtar policor i lënduar, dhe për këtë gjë është i kënaqur. Tutje tha se janë parë protestues të lënduar, një dhunë e ushtruar ndaj tyre dhe në mesin e tyre ka pasur edhe deputet të lënduar.

A vlerësoni se dhuna e ushtruar ndaj protestuesve ka qenë e nevojshme për mbrojtjen e institucioneve të Kosovës, dhe a vlerësoni që mbrojtja e objektit të Qeverisë së Kosovës, mbrohet në distancën që është bërë nga ana e policisë, pasi dhuna është përdorur përgjatë sheshit “Nena Terezë” dhe “Zahir Pajaziti”?

**Bajram Rexhepi-** Tha se nga policia në rast të përdorimit të forcës, përdoret termi forcë proporcionale dhe jo “dhunë nga policia”, dhe se për këtë është raporti i monitoruesve të EULEX-it, të Policisë së Kosovës dhe të IPK-së. Në rast se nga zyrtarët policor është tejkaluar forca, atëherë këto raste janë nën hetime, pasi operacioni është zhvilluar në përputhe me situatën.

Gjithashtu shtoi se, protesta është zhvilluar në sheshin që është në ndërtim e sipër, në të cilin gjenden kubëza të cilat përbëjnë rrezik, gjithashtu është përdorur ngjyra ndaj policëve dhe për shkaqe operative janë larguar në një distancë të caktuar, për ti shmangur përdorimin e mjeteve potencialisht të rrezikshme.

Gjithashtu kërkoi që të dijë, se cili nga deputetët ka qenë i lënduar gjatë protestës?

**Rexhep Selimi-** Tha se deputeti i lënduar ka qenë , Liburn Aliu. Tutje pyeti, se a vlerëson se deputeti, Liburn Aliu ka qenë i dhunshëm në ditën kur është zhvilluar protesta, si dhe a vlerëson se ky deputet nuk është lënduar?

**Bajram Rexhepi-** Tha se deputeti, Liburn Aliu është lënduar dhe në doktrinën kirurgjike ky lloj lëndimi trajtohet si lëndim i lehtë.

**Rexhep Selimi-** A konsideroni se deputeti, Liburn Aliu ka qenë i dhunshëm ndaj policisë, për ti ju përgjigjur me dhunën që është ushtruar ndaj tij?

**Bajram Rexhepi-** Tha se për këtë rast do të jap përgjigjeje me shkrim dhe të dokumentuar në ditët në vijim.

**Rexhep Selimi-** Në situatën politike të krijuar në veri të vendit, përveç vrasjes së zyrtarit policor, Enver Zymberi, ka qenë edhe vrasja e një qytetari, Selver Haradinaj në lagjen “Tre rrokaqiejt”.

Tutje tha se nga ana e Ministrit të Punëve të Brendshme, është deklaruar që vrasja e Selver Haradinaj, nuk është bërë nga ana e serbëve.

Duke u nisur nga kjo deklaratë, a mund të dihet se kush ka vrarë Selver Haradinaj?

**Bajram Rexhepi-** Ky konstatim është nga konteksti i ngjarjeve, pasi fillimisht paragjykimi ka qenë se Selver Haradinaj është vrarë nga serbët, por hetimet që janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen ende nuk e kanë sqaruar këtë rast dhe se pa argumente nuk duhet të akuzohet asnjë palë. Analizat e bëra dhe mënyra e veprimit ende janë nën hetime dhe kushdo qoftë që e ka bërë këtë vepër do të merr dënimin e merituar.

**Rexhep Selimi-** Për skandalin me pasaporta në Ministrinë e Punëve të Brendshme, bëri pyetjet si në vijim, drejtuar Ministrit, Bajram Rexhepi.

A konsideroni se ajo çfarë ka ndodhur në procesin e prodhimit të pasaportave është një skandal? A konsideroni se me këtë skandal është dëmtuar qytetari i Kosovës dhe imazhi i vendit si dhe aspirata drejt liberalizimit të vizave?

A jen i përfshirë në skandalin e pasaportave?

**Bajram Rexhepi-** Tha se nuk është i përfshirë në skandalin e pasaportave dhe se edhe në Kuvendin e Kosovës ka deklaruar se ky proces ka filluar pastër dhe ndërkohë kanë lindur problemet dhe si Ministër ka marrë masa ndaj atyre që kanë pasur përgjegjësi menaxhuese në këtë projekt.

Tutje tha se këtu janë dy çështje, njëra është raporti mes kompanisë "Osterreichische Staatsdruckerei", dhe përfaqësueses së tyre që hetohet, por me qenë se është deklaruar se ka edhe zyrtar të MPB-së, të përfshirë në këtë proces, kam kërkuar hetime, përfshirë edhe nga EULEX-i, dhe se Ministri i Punëve të Brendshme, nuk ka qenë i përfshirë në këtë proces.

**Rexhep Selimi-** Pyeti Ministrin, nëse e din që Kontrata mes Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Kompanisë austriake për prodhimin e pasaportave biometrike është ndërprerë me 3dhjetor 2012?

Gjithashtu pyeti se një veturë e falsifikuar thuhet se është gjetur si pronë e Ministrit të Punëve të Brendshme, z. Rexhepi. A mund ta sqaroni këtë situatë?

**Bajram Rexhepi-** Kjo çështje është në vazhden e spekulimeve, pasi nga ana ime është deklaruar që posedoj "Rang Rower" të 2012 dhe posedoj të gjitha dokumentacionin, ndërsa veturë të tipit "Chrysler" nuk ka poseduar asnjëherë.

**Rexhep Selimi-** Theksoi se njëra ndër çështjet e ndjeshme që ka ndodhur ditëve të fundit është edhe çështja e përgjimeve. Gjithashtu nga ana e Ministrit të Punëve të Brendshme është pohuar se Ministri dhe Kryeministri janë përgjuar gjatë operacionit të 25 korrikut, të vitit 2011, në veri të vendit dhe në lidhje me këtë bëri pyetjen.

A është kuptuar nga ana e Ministrit të Punëve të Brendshme, se nga kush është përgjuar?

**Bajram Rexhepi-** Në përgjigjeje të kësaj pyetje, tha se që nga koha kur ka qenë Kryeministër, shumica e zyrtarëve të lartë kanë qenë të përgjuar, qoftë nga struktura e UNMIK-ut, dhe më vonë të EULEX-it, apo nga shërbimet caktuara ndërkombëtare, të cilat kanë dashur që situatën ta kenë nën kontroll. Për këtë gjë është bërë verifikimi, dhe nga strukturat vendore nuk është bërë përgjimi, pasi ato i përmbahen ligjshmërisë. Gjithashtu tha se tani Ligji për përgjimet i cili është proceduar nga ana e Qeverisë, i cili është penguar nga EULEX-i, pasi ia ngushton hapësirën e përgjimit dhe se ky ligj përcakton qartë se kur mund të përgjohet.

**Rexhep Selimi-** Për Ligjin për Përgjimet, duke iu referuar deklaramete të Ministrit, se ka pengesa nga EULEX-i, në procedimin e këtij ligji. Cilat janë pengesat që i ka bërë Ministrisë së punëve të Brendshme, EULEX-i?

**Bajram Rexhepi-** Për Ligjin për përgjimin e telekomunikimeve, tha se është sponsorizuar nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë dhe nuk është direkt në



kompetencën e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ndërsa në pjesën e këtij ligji, ku duhet të definuar qartë se në çfarë raste mund të bëhen përgjimet dhe në çfarë forme, EULEX-i, ka kundërshtuar dhe ka penguar promovimin e këtij projektligji në Kuvend. Pas paraqitjes së disa përgjimeve në media, është marrë vendim procedimi i ligjit në Kuvend, në mënyrë që çështja e përgjimeve të përcaktohet qartë.

**Rexhep Selimi-** Referuar fjalisë së Ministrit, Rexhepi, se “strukturat legale të Serbisë janë në veri”, tha se duke e vlerësuar se struktura e një shteti tjetër veprojnë në Kosovë, konsideroi se ky territor mund të quhet si i pushtuar nga ana e Serbisë. Nisur nga kjo situatë bëri pyetjen si në vijim.

A ju ka shkuar ndër mend që të jepni dorëheqje?

**Bajram Rexhepi-** Tha se vlerësimi si territor i pushtuar, nga ana e z. Selimi, është qëndrim politik, ndërsa konsideroi se në veri të vendit ka disa probleme, ndërsa pyetjes se a do të jap dorëheqje, tha se këtë do ta jap kur ta shkarkon Kryeministri i Kosovës dhe kur të bindet se nuk i kryen detyrat ashtu siç duhet.

**Anton Quni-** Ngriti tri çështje, për të cilat kërkoi përgjigjeje nga Ministri i Punëve të Brendshme. Çështja e menaxhimit të situatave dhe turmave, gradimeve në Policinë e Kosovës dhe buxhetin. Për protesta e 17-18 tetorit, 2012, konsideroi se ka pasur ushtrim të dhunës duke e krijuar një imazh jo të mirë.

Tutje shtroi pyetjet si në vijim, drejtuar Ministrit, z. Bajram Rexhepi. Deklarimet nga ana e Ministrit, kërcënimet ndaj deputetëve, Kryetarit të Kuvendit, protestuesve, a mendoni se e keni tensionuar edhe më shumë situatën e krijuar?

A mendoni se goditjet ndaj zyrtarëve policor, të bëra nga ana e protestuesve është një mllef që kanë qytetarët ndaj Ministrit?

Si i vlerësoni pasojat, me implikimin e drejtpërdrejta të Ministrit në zinxhirin komandues dhe në menaxhimin e gjithë situatës?

**Bajram Rexhepi-** Për menaxhimin e demonstratave, tha se për çdo polici kjo çështje është një sfidë, ndërsa pyetjes së nga ana e tij është bërë kërcënim tha se nuk kanë qenë të tilla, por Ministria e Punëve të Brendshme, është përgjegjëse për ruajtjen e objekteve shtetërore, gjithashtu shtoi se nuk është e vërtetë se njësia speciale ka hyrë në Kuvend.

**Anton Quni-** Për çështje e gradimeve, tha se për të gjithë ata persona që e kanë pas të drejtën e konkurrimit në gradën e Nënkolonelit, ku paraprakisht janë deklaruar 32 pozita, kanë konkurruar 23 zyrtar të policisë, nga këta janë pranuar 19 zyrtar, ndërsa 4 prej tyre kanë dështuar.

Tutje tha se, ka indikacione dhe për këtë kërkoi qëndrimin e Ministrit se nga ana e tij është interferuar në përzgjedhjen e kandidatëve potencial për gradën e Nënkolonelit dhe se Komisioni që ka bërë vlerësimet e kandidatëve, janë detyruar ta shpallin listën e atyre që kanë kaluar testimin, duke u bazuar në preferencat e Ministrit të MPB-së.

**Bajram Rexhepi-** Për çështje e gradimeve tha se në Policinë e Kosovës, për shtatë vite nuk ka pasur gradime, ndërsa në momentin që e kam marr pozitën e Ministrit, kamë kërkuar që ky proces të vazhdoj.

Gjithashtu tha se , për pyetjen e z. Quni, se ai mund të ketë ndikuar në këtë proces, tha se kjo mund të jetë shpifje dhe se mund të jetë i keq informuar, pasi Drejtori i Policisë bashkë me bordin i kanë kriteret se si bëhet përzgjedhja e kandidatëve dhe se qëllimi është që struktura e policisë të mbahet larg interferimeve politike.

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Shpend Maxhuni-** Për procesin e avancimit në karrierë, tha se për procesin e gradimit për Nënkolonel, i cili është përmbyllur është bazuar në kriteret që kanë përmbushur kandidatët, gjithashtu shtoi se 4 prej tyre nuk kanë kaluar testimin për Nënkolonel. Gjithashtu shtoi se për çdo zyrtar policor mund të dëshmohet vlerësimi i performancës, duke theksuar se për rastet e caktuara që janë subjekt i hetimit të brendshëm apo penale, për të cilën është kompetente IPK-ja, nuk e pengon askënd që të jetë pjesë e garës

Gjithashtu shtoi se me përgjegjësi, profesionale dhe morale e pranon që, Ministri, Bajram Rexhepi, më asnjë rrethana nuk ka interferuar në procesin e gradimit të zyrtarëve policor, si dhe as nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm nuk është ndikuar, por kanë qenë panelet vlerësuese që janë marrë me këtë proces. Ky proces, që nga dita e parë është monitoruar nga EULEX-i, gjithashtu janë ftuar zyrtar nga ICITAP-i.

**Anton Quni-** Tha se për informacionin që posedon për çështjen e gradimeve në polici, nuk është spekulim por janë informata nga autoritetet e policisë dhe me qëllim të sqarimit të kësaj shtate, kërkoi që Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, të ketë qasje të plotë në procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve potencial për avancimet në karriere brenda Policisë së Kosovës.

Ndërsa për çështjen e buxhetit të Policisë së Kosovës, tha se ka limite në disa fusha. Gjithashtu nga ana e Ministrit, Rexhepi, u theksua se Policia e Kosovës nuk i ka kapacitetet e plota për ndërmarrjen e operacioneve më komplekse në veri të vendit, ndërsa në buxhetin e vitit 2013, nuk është vërejtur që do të ketë tregues për përmirësimin e përmbushjes së operacioneve, pasi fondet janë të limituara për operacione speciale, për hetime, trajnime, mobilitetin e njësive të policisë, programin e mbrojtjes së dëshmitarëve etj.

Në lidhje me këtë bëri pyetjen, se ku qëndron problemi, tek politikat e Ministrisë, Policia e Kosovës, apo është pjesë e politikës së Ministrisë që edhe në vitin 2013 të mos të merret me pjesën veriore të Kosovës?

**Bajram Rexhepi-** Për nevojat buxhetore të Policisë së Kosovës, tha se krahas limiteve buxhetore që ekzistojnë duhet bërë shpërndarja e tyre. Gjithashtu nevoja për pajisje të reja është evidente dhe se në fund të vitit 2012, do të bëhet pajisja me autoblanda dhe transportier të blinduar për Policinë e Kosovës. Për reagimet emergjente është bërë kërkesa për helikopter, pasi përgatitja e njësive dhe bazës ligjore është bërë. Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të policisë, dedikohet për pagat mujore dhe për shërbime dhe për projekte kapitale mbeten pak mundësi financiare.

**Vjollca Krasniqi-** Për raportet e paraqitura nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës, tha se janë vlerësuar dhe se Komisioni ka vlerësuar që gjatë protestës së zhvilluar me 17-18 nëntor, ka pasur ushtrim të dhunës.

Në raportin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka pasur standard të dyfishtë të evidentimit e të lënduarve, pasi bëhet evidentimi i zyrtarëve policor të lënduar, ndërsa për qytetarët nuk ka asnjë të dhënë. Gjithashtu standard i dyfishtë në reagim, është edhe në rastin e protestës së Lëvizjes Vetëvendosje me 17-18 nëntor, dhe protestës me rastin e promovimit të autostradës.

Në Komision, nga disa anëtarë jeni vlerësuar se reagimi i juaj gjatë protestës së Lëvizjes Vetëvendosje, ka qenë emocional kur është dhënë urdhër për tu vepruar ndërsa, gjatë protestës për promovimin e autostradës reagimi ishte ndryshe.

Sipas informacioneve të Zyrës për Informim, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, një numër i madh i zyrtarëve policor janë të suspenduar për vepra kriminale dhe për keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Tutje përmendi rastin e vjedhjes në Dhomën e dëshmime në Prishtinë, që përveç suspendimit të disa zyrtarëve policor, nuk është zbardhur asgjë për këtë rast, ndërsa në rastin e vjedhjes në Dhomën e Dëshmime në Pejë, janë ndërmarrë disa veprime më të mëdha. Gjithashtu suspendimi i disa zyrtarëve të lartë të MPB-së, me rastin e keqpërdorimeve në procesin e prodhimit të pasaportave.

Në lidhje me këto suspendime në Ministrinë e Punëve të Brendshme, bëri pyetjen si në vijim.

Suspendimet që janë bërë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, a kanë të bëjnë me aferën e pasaportave, apo keqpërdorim të detyrës zyrtare?

**Bajram Rexhepi-** Për veprimin e tij, në rastin e protestave të 17-18 nëntorit, tha se mund të ketë qenë një dozë emocionale, por në një situatë të njëjtë, prapë njëjtë do të vepronte. Ndërsa, se pse kam qenë i qetë gjatë protestave për promovimin e autostradës, tha se ka dashur të jap mesazhin protestuesve të dhunshëm, që nuk do të përdoret forca. Ndërsa për çështjen e hetimeve tha se, fakti nëse disa zyrtar janë nën hetime, kjo duhet vlerësuar si pozitive.

Ndërsa për Dhomën e Dëshmisë në Prishtinë, tha se kjo ka ndodhur në kohën kur nuk ka qenë Ministër i MPB-së, dhe kjo çështje është marrë përsipër nga EULEX-i, ndërsa për rastin e vjedhjes në Dhomën e Dëshmisë në Pejë, është premtuar që do të zgjidhet dhe se procedurat e hetimit janë të avancuara dhe personat e dyshuar janë në procedurat gjyqësore, ndërsa për të suspenduarit në MPB, tha se kanë pasur përgjegjësi menaxheriale, por hetuesia do të vendos nëse këta zyrtarë janë përgjegjës.

**Shpend Maxhuni-** Për të qenë transparent me qytetarët e Kosovës, Policia e Kosovës bën publikimin e të dhënave statistikore, përfshirë edhe rastet e suspendimeve që janë bërë si rezultat i shkeljes së procedurave ligjore dhe janë organet e drejtësisë që vendosin për fajësinë e tyre.

**Rasim Demiri-** Përgëzoi Ministrin për punën e bërë deri tani, dhe bëri pyetjen si në vijim.

Si është situata në “Lagjen e Boshnjakëve” në veri të Mitrovicës?

**Bajram Rexhepi-** Situata në “Lagjen e Boshnjakëve” është e qetë, por ka tensione të kohëpaskohshme dhe se në këtë lagje është prezenca e madhe e Policisë së Kosovës. Në rast të paralajmërimeve për tensione, shtohet numri i zyrtarëve policor vendor si dhe të

EULEX-it dhe KFOR-it. Edhe në këtë lagje ka disa qytetarë që janë të përfshirë në kontrabandim.

**Danush Ademi-** Tha se për dymbëdhjetë vite në radhët e Policisë së Kosovës, janë një numër i komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas të punësuar dhe asnjëherë nuk janë graduar deri tani.

Pse nuk është bërë gradimi për komunitetin romë, ashkali dhe egjiptas?

**Bajram Rexhepi-** Për çështjen e gradave, tha se merren në bazë të nivelit të edukimit dhe të performancës.

**Shpend Maxhuni-** Në të ardhmen do të ketë mundësi për promovimin në karrierë dhe se gradimi bëhet në fazë, ku do të kenë mundësi të gjithë për tu promovuar.

**Kryetari i Komisionit-** Këtë takim duhet ta kuptojmë në nivelin e bashkëpunimit Ministri- Komision dhe se kërkesa e Komisionit është që mos të ketë veprime të cilat mund të jenë jo ligjore në Ministri, të mos ketë veprime kundër ligjore. Si autoritete përgjegjëse kemi përgjegjësi për zbatimin e ligjeve dhe jo shpërndarjen emocioneve, urdhri i dhënë nga ana juaj nuk korrespondon me ligjin për Policinë e Kosovës, prandaj dhënie e urdhrave duhet bërë nga Drejtorët por jo nga ana e Ministrisë.

**Bajram Rexhepi-** Bashkëpunimin me Komisionin e vlerësoi si të dobishëm, dhe se kjo bëhet në bazë të ligjit, ndërsa sugjeroi që mos të kërkohej që të jetë i pranishëm shpesh në Komision, pasi ka edhe prioritete të tjera. Gjithashtu shtoi se në të mirë të qytetarëve, të shfrytëzohet baza ligjore që lejon bashkëpunimin mes Komisionit dhe Ministrisë, për transparencën e institucionit, duke mos u shfrytëzuar kjo hapësirë si show-medial.

**Kryetari i Komisionit-** Detyra e Komisionit është që garantojmë zbatimin e ligjit, pasi si përpilues të tyre duhet të mbikëqyrin zbatueshmërinë e ligjeve. Në përfundim të kësaj pike të rendin të ditës, falënderoi Ministrin dhe Drejtorin e Përgjithshëm të policisë për raportimin në Komision.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013**

**Kryetari i Komisionit-** Për kërkesat buxhetore të paraqitura në Komision për vitin 2013, nga ana e agjencive, ftoi anëtarët që të diskutojnë.

A ka vërejtje për kërkesat buxhetore të agjencive të paraqitura në Komision?

**Fatmir Xhelili-** Për kërkesat buxhetore për vitin 2013, nga agjencitë që mbikëqyren nga ana e Komisionit, tha se Policia e Kosovës ka bërë kërkesë konkrete dhe të mirë planifikuar, duke përcaktuar prioritetet që ka nevojë, siç është rritja e numrit të zyrtarëve policor, për shkak të marrjes së përgjegjësisë në të ardhmen për mbikëqyrjen vijës kufitare me Serbinë, dhe se këtë kërkesë Komisioni duhet të përkrah. Për investimet kapitale, kërkesat janë të drejta, edhe pse mund të ketë kufizime nga ana e FMN-së, këto kërkesa duhet të përkrahen.

Ndërsa tek kërkesa për mallra dhe shërbime, nuk është prezantuar vlerësim i mirëfilltë për shpenzimet e derivateve të naftës dhe të pajisjeve me pjesë rezervë, për mirëmbajtjen e automjeteve, niveli i parkut të policisë tani, sa vetura janë të vjetruara, për sa vetura ka nevojë parku i policisë etj. Tutje propozoi që në parim, Komisioni ti përkrah kërkesat buxhetore të policisë tek Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Ndërsa kërkesës buxhetore të IPK-së, kërkoi që Komisioni të përkrah këtë kërkesë, gjithashtu bëri vërejtje që ky institucion nuk ka bërë përzgjedhjen e njërës prej ndërtesave publike për akomodimin e stafit, por kanë bërë ndërtimin e një ndërtese të re, dhe se këto investime mund të shkonin për çështje operative, bashkëpunëtor dhe informator për këtë institucion.

Ndërsa për kërkesën buxhetore të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, tha se për periudhën kohore që është krijuar dhe nivelin e trajnimeve është i mjaftueshëm buxheti për kryerjen e detyrave zyrtare. Gjithashtu kritikoi që as kjo agjenci nuk ka bërë zgjidhje për akomodim, në ndonjë ndërtesë publike, por edhe në vitin 2013 është planifikuar të vazhdohet në objektin me qira, në shumën 50 mijë euro, dhe se këtë kërkesë buxhetore nuk do përkrahte.

**Anton Quni-** Përkrah kërkesat buxhetore drejtuar Komisionit për vitin 2013, gjithashtu përkrah mendimin e z. Xhelili.

**Rexhep Selimi-** Kërkesat buxhetore shtesë të agjencive, do duhet ti përkrahim në parim, pasi i kontribuojnë zhvillimit të tyre. Tutje tha se është kundër suspendimit të buxhetit, për njësinë speciale të Policisë së Kosovës, Hetimeve dhe se në parim përkrah kërkesat buxhetore drejtuar Komisionit.

**Vjollca Krasniqi-** Tha se mbështet qëndrimin e z. Xhelili, për kërkesën buxhetore nga ana e Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen të Dhënave Personale, për qiranë, pasi ka objekte të cilat mund të shfrytëzohen dhe se përkrah qëndrimin që mos të shtohen mjete financiare për qira.

**Fatmir Xhelili-** Propozoi që të kërkohet një përgjigjeje nga ana e Qeverisë së Kosovës, se si janë planifikuar politikat e krijimit të Njësive të helikopterëve, pranë FSK-së dhe Policisë së Kosovës, marrë parasysh buxhetin e kufizuar të Kosovës.

A janë planifikime të pa koordinuara mes Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe MFSK-së, apo qëllimi është krijimi i dy njësive?

**Kryetari i Komisionit-** Mund të konsiderojmë si të domosdoshme kërkesën Policisë së Kosovës, dhe se e përkrahim në Komisionin për Buxhet dhe Financa, gjithashtu mbështet idenë që të bëhet shfrytëzimi i objekteve publike, duke shmangur pagesën e qerasë.

Gjithashtu njoftoi se nga takimi me Sekretarin e Përgjithshëm të MFSK-së, kanë kërkesa buxhetore të arsyeshme dhe që i shërbejnë FSK-në, siç janë operacionet, mbajtja e kurseve, helikopterët, autobлиндat, dhe që duhet të shqyrtohen në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

**Rexhep Selimi-** Tha se e përkrah mendimin e z. Xhelili, për kufizimet buxhetore për çështjen e qerasë, pasi ka mundësi që të zgjidhet çështja e akomodimit të Agjencisë për

Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjithashtu tha se e përkrah kërkesën buxhetore nga ana e MFSK-së, duke qenë se buxheti i saj është i kufizuar.

**Kryetari i Komisionit-** Për kërkesat buxhetore të bëra nga ana e agjencive, tha se nëse anëtarët janë dakord ti dërgohet rekomandim me shkrim, Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Anëtarët ranë dakord që ti dërgohet rekomandim me shkrim, Komisionit për Buxhet dhe Financa për përkrahjen e kërkesave buxhetore të agjencive që mbikëqyren nga Komisioni.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

**Përgatitur nga:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Ahmet Isufi**